

# TEMA E MODULIT

## TRAJNIMI I PËRGJITHSHËM

### EKZEKUTIMI I DETYRUAR NJOHURI TË THELLUARA JURIDIKE DHE PRAKTIKE 3 MUAJ

#### ❖ Pse duhet të ndiqni modulën e trajnimit të përgjithshëm

Qendra Kombëtare e Trajnimit të Përmbartuesve ofron mundësinë e ndjekjes së modulit të trajnimit të përgjithshëm “*Ekzekutimi i detyruar – njohuri të thelluara juridike dhe praktike*” 3-mujor, për të përfituar njohuri specifike dhe ekskluzive juridike në fushën e ekzekutimit të detyruar (përmbartimit).

Moduli mundëson fitimin e njohurive të nevojshme mbi Institutin e Ekzekutimit të Detyruar, ofron njohje të detajuar teorike dhe praktike të shërbimit përmbartimor gjyqësor dhe trajnon pjesëmarrësit mbi përdorimin e mjeteve ligjore gjatë një procesi të ekzekutimit të detyrueshëm përmbartimor.

Njohuritë e përftuara, pavarësisht formimit bazë të ndjekësve të modulit, do të ndihmojnë në përgatitjen e pjesëmarrësve mbi përdorimin e kuadrit ligjor në fuqi, specifikisht në fushën e ekzekutimit të detyrueshëm.

Njohuritë e përftuara, do të shërbejnë dhe do të mund të përdoren nga të gjithë pjesëmarrësit, studentët e drejtësisë, juristët apo të interesuarit që punojnë, apo do të punësohen në fusha të ndryshme si kompani private apo institucione të ndryshme shtetërore, banka, zyra avokatie, ndërmjetësimi, apo dhe përmbartimi.

Kursi trajnues do të shërbejë edhe si forum aktiv ku do të diskutohen në formë interaktive materiale specifike të fushës së ligjit, veçanërisht ekzekutimit të detyrueshëm, sipas kërkesave dhe nevojave reale të pjesëmarrësve.

#### ❖ Aftësitë dhe kompetencat që mund të përfitohen me përfundimin e trajnimit

Në përfundim të këtij trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë të aftë të njohin më specifikisht fushën e ekzekutimit të detyrueshëm, duke thelluar aftësitë e tyre teorike dhe duke marrë një orientim të plotë sa i përket profesionit dhe karrierës.

Trajnimi bën të mundur përfundimin e njohurive praktike mbi hulumtimin, analizimin dhe zbatimin e legjislacionit në fushën e ekzekutimit të detyruar. Ndjekja sistematike e tij do të ndihmojë në krijimin e aftësive të pjesëmarrësve për të komunikuar profesionalisht me njerëz të të gjitha niveleve, fushave dhe strukturave shoqërore mbi fushën specifike të ekzekutimit të detyrueshëm (përmbartimit).

Pjesëmarrësit në përfundimin me sukses të ndjekjes së orëve të trajnimit do të pajisen me aftësitë e nevojshme për njohjen e detajuar të dokumentacionit ligjor që lidhet me çështjet dhe procedurat përbarimore sikundër dhe përpilimin e akteve që i përgjigjen një procesi ekzekutues. Përmes përfutimit të dijeve të thelluara në këtë fushë, pjesëmarrësit do të mund të përdorin teknika bashkëkohore edhe për planifikimin e karrierës së tyre në fushën e së drejtës.

#### ❖ **Kujt i adresohet ky modul trajnimi**

Ky modul, për vetë natyrën e përgjithshme dhe metodikën se si është ndërtuar, u shërben të gjithë të interesuarve, që mund të jenë të fushave dhe disiplinave të ndryshme, me qëllim familjarizimin me fushën e ligjit dhe veçanërisht, atë të ekzekutimit të detyrueshëm.

Kushdo, nga çdo sfond i formimit profesional, me dëshirë për fitimin e aftësive dhe njohurive të reja, mund të ndjekë trajnimin dhe të përftojë njohuri të thelluara juridike e praktike mbi ekzekutimin e detyruar/përbarimin, si proces ligjor në materializimin e drejtësisë së dhënë.

Ky trajnim ju shërben profesionistëve të rinj, të cilët duan të planifikojnë sa më mirë karrierën e tyre, jo vetëm studentëve të së drejtës, si dhe të gjithë profesionistëve më me eksperiencë, të cilët duan ta riorientojnë veten dhe karrierën në tregun e punës duke pasur dhe ofruar tek punëdhënësit njohuri profesionale dhe specifike të thelluara.

#### ❖ **Numri i orëve të modulit**

Ky modul përbëhet nga 36 orë, të cilat zhvillohen nga 3 orë në javë, për 12 javë. Orët do të kenë një shtrirje kohore 60 minuta.

Orari do të organizohet sipas një agjende fleksibël referuar nevojave të auditorit që do të marrë pjesë dhe do të gjejë për secilën orë trajnimi shërbimin profesional të trajnerëve të specializuar të fushës, të cilët do të zhvillojnë trajnimet sipas tematikave të modulit.

#### ❖ **Përmbajtja e modulit të trajnimit të përgjithshëm**

Moduli i trajnimit përmban një ndërthurje të njohurive bazë teorike, me shembuj konkretë nga praktika rreth proceseve që lidhen me to, duke nisur nga prezantimi me rëndësinë e shërbimit përbarimor në një shtet të së drejtës, ekzekutimin e detyruar në gjithë komponentët përbërës të tij, deri te njohuritë specifike për të mundësuar ekzekutimin e titujve ekzekutivë dhe mekanizmat e mbrojtjes ligjore ndaj tyre.

#### ❖ **Tematikat që do të shtjellohen gjatë trajnimit të përgjithshëm**

1. *Përbaruesi. Roli dhe funksioni i shërbimit përbarimor gjyqësor në sistemin e drejtësisë. (1 orë)*
2. *Legjislacioni mbi ekzekutimin e detyruar. Njohja dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore të huaja në çështjet civile ose tregtare. (1 orë)*
3. *Zyra e përbarimit privat, funksionet, organizimi dhe veprimtaria e përbaruesit gjyqësor privat. (1 orë)*
4. *Titujt ekzekutivë. Urdhri i ekzekutimit. Llojet e detyrimeve të ekzekutueshme dhe ekzekutimi i tyre. (1 orë)*
5. *Detyrimi. Origjina e detyrimit. Aktet për dhënien e kredive bankare. Kontratat bankare. Detyrimet monetare. (2 orë)*
6. *Procedurat e falimentimit. Përbarimi ndaj debitorit dhe pronave të tij. (1 orë)*
7. *Vendimet me ekzekutimin të përkohshëm. Masat e sigurimit të padisë. Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Administrative. (1 orë)*

8. *Paraqitja dhe hartimi i padisë, deklarata e mbrojtjes. Kundërpadia. Heqja dorë nga gjykimi dhe e drejta e padisë. (1 orë)*
9. *Njoftimet. Mënyrat e njoftimit. Roli i përmbauesit në njoftime. Rëndësia e akteve të nxjerra nga përmbauesi gjyqësor, mënyra e komunikimit të tyre dhe rëndësia e njoftimit të palëve në proces. (1 orë)*
10. *Kuptimi dhe llojet e përfaqësimit. Prokura dhe autorizimi. (1 orë)*
11. *Parashkrimi, afatet. Ndërprerja dhe pezullimi i parashkrimit. Prekluziviteti. (1 orë)*
12. *Ekzekutimi dhe shuarja e detyrimeve. Vendi, afati i ekzekutimit të detyrimit. Zëvendësimi dhe kalimi i kredisë. (1 orë)*
13. *Pengu. Hipoteka. Dorëzania. (1 orë)*
14. *Preferimet (privilegjet). Radha e preferimit në procesin përmbauesor. (1 orë)*
15. *Tatimet, taksat, kontributet. Evazioni fiskal. (1 orë)*
16. *Etika dhe komunikimi. Rëndësia e kodit të sjelljes. Etika në ofrimin e shërbimit publik dhe etika deontologjike. (1 orë)*
17. *Aktet administrative. Vlefshmëria e akteve administrative. Shfuqizimi dhe revokimi. (1 orë)*
18. *Dokumenti, vula dhe nënshkrimi elektronik. Legjislacioni. Praktika. (1 orë)*
19. *Funksioni i përmbauesit gjyqësor privat. Marrëdhënia me palët në një proces të ekzekutimit të detyrueshëm. Marrëdhënia kontraktore me palën kreditore. Tarifat dhe kostot e shërbimit përmbauesor. (1 orë)*
20. *Vënia në ekzekutim e një titulli ekzekutiv. Fillimi i ekzekutimit të detyrueshëm. Hapat proceduralë të ekzekutimit. (1 orë)*
21. *Ekzekutimi mbi sende të luajtshme dhe sende të paluajtshme. Ankandi. (1 orë)*
22. *Ekzekutimi mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet që personat e tretë i detyrohen debitorit. (1 orë)*
23. *Mjetet e mbrojtjes ndaj ekzekutimit të detyrueshëm. Kundërshtimi i veprimeve përmbauese dhe pavlefshmëria e titullit ekzekutiv. (1 orë)*
24. *Pezullimi, pushimi i ekzekutimit. Ankimi kundër pezullimit dhe pushimit të ekzekutimit. (1 orë)*
25. *Shoqëritë tregtare, aktiviteti dhe personaliteti juridik. (1 orë)*
26. *Pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare. (1 orë)*
27. *Ekzekutimi i detyrimeve ndaj institucioneve shtetërore. (1 orë)*
28. *Dëmi jashtëkontraktor. Përgjegjësia jashtëkontraktore e organeve të administratës shtetërore. Padia. Shpërblimi i dëmit të shkaktuar. (1 orë)*
29. *Aktiviteti dytësor i përmbauesit gjyqësor privat. (1 orë)*
30. *Papajtuueshmëritë. Konflikti i interesit. Konfidencialiteti dhe praktika të ndaluara të përmbauesit gjyqësor privat. (1 orë)*
31. *Kontrolli dhe mbikëqyrja e veprimtarisë së përmbauesve gjyqësorë privatë. (1 orë)*
32. *Çështje praktike përmbauese – shembuj – diskutime. (1 orë)*
33. *Përmbauesi midis ligjit dhe ekonomisë. (1 orë)*
34. *Test interaktiv. (1 orë)*
35. *Përmbledhje. (1 orë)*

#### ❖ **Kush e ofron trajnimin**

Tematikat e modulit zhvillohen nga trajnerë me një përvojë të gjatë në fushën e së drejtës, jo vetëm nga ana e ushtrimit praktik të profesionit, por edhe me një angazhim të gjatë në mësimdhënie. Për t'u njohur me trajnerët, kliko në link-un vijues: [www.bailiff-training-center.al](http://www.bailiff-training-center.al)

#### ❖ **Si realizohet moduli i trajnimit**

Metodologjia që do të përdoret në këtë modul: Trajnim i drejtpërdrejtë, komunikim interaktiv nëpërmjet diskutimit dhe debatit. Trajnimet do të zhvillohen në ambientet e Qendrës Kombëtare të Trajnimit të Përmbauesve, pranë Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, në kushte optimale dhe bashkëkohore në të dyja format e ofrimit të mësimdhënies.

#### ❖ **Kohëzgjatja & Certifikata**

Ky modul trajnimi ofrohet në auditor dhe/ose online, përmes 36 orëve trajnimi të shtrira në një kohëzgjatje 3-mujore. Në fund të trajnimit, secili pjesëmarrës që ka ndjekur të 36 orët e trajnimit, pajiset me certifikatën përkatëse nga Qendra Kombëtare e Trajnimit të Përmbauesve.

#### ❖ **Kontaktet për personat e interesuar:**

*Adresa: Rruga “Nikolla Jorga”, ndërtesa 9, kati II, Tiranë*

*E-mail: [qendra.trajnimit.permbaruesve@gmail.com](mailto:qendra.trajnimit.permbaruesve@gmail.com)*

*Tel.: +355 68 605 4005*